

Abdurrahim MAXHUNI
Instituti Albanologjik
Prishtinë

**NDIHMESA GJUHËSORE E PROFESOR XHEVAT
LLOSHIT NË REVISTAT E INSTITUTIT
ALBANOLOGJIK**

Punim studimor

Përmbajtje e shkurtër: Veprimtaria shkencore e profesor Xhevat Lloshit është e gjatë dhe e larmishme. Ai është personalitet i shquar i gjuhësisë shqiptare. Është pjesëmarrës në Kongresin e Drejtshkrimit (1972), leksikograf i shquar, emrin e të cilit e mbajnë shumë fjalorë, njohës i mirë i leksikologjisë dhe i shqipes standarde, autor i shumë studimeve të rëndësishme për fusha të ndryshme, pjesëmarrës në shumë tubime shkencore. Emrin e tij e gjejmë në revistat dhe në konferencat shkencore të Institutit Albanologjik. Për angazhimin e tij shkencor, Instituti Albanologjik e ka nderuar me çmimin *Anëtar Nderi*. Në këtë punim do të ndalemi tek shkrimet e tij, të botuara në dy revistat shkencore “Gjuha shqipe” dhe “Gjurmime albanologjike”-seria e shkencave filologjike.

Fjalët çelësa: ndihmesë, revistë, Instituti Albanologjik, Xhevat Lloshi.

Hyrje

Profesor Xhevat Lloshi është një nga personalitetet më të shquara të gjuhësisë shqiptare. Veprimtaria e tij është e gjerë dhe e pasur. Është një ndër gjuhëtarët më produktivë, me një varg studimesh origjinale. Në krijimtarinë e tij gjejmë vepra, monografi, studime, artikuj, kumtesa, shkrime, referate e intervista, duke qenë i

pranishëm në të gjithë hapësirën shqiptare. Në fushë të studimeve gjuhësore shqiptare vlerësohet sidomos për kontributet e tij në fushën e leksikografisë e të leksikologjisë, në fushën e stilistikës, në fushën e historisë së shqipes së shkruar të autorëve të mëdhenj, si: Kristoforidhi, Frashëri, Qiriazi, në fushën e gjuhës standarde dhe të kulturës së gjuhës, i cili ka qenë edhe pjesëmarrës në Kongresin e Drejtshkrimit. Emrin e profesor Lloshit e gjejmë në veprat: *Fjalor i Gjuhës Shqipe* (1980), *Fjalor i emrave të bimëve dhe të kafshëve* (anglisht-shqip dhe shqip-latinisht-anglisht 2016), *Shqipja gjuhë e hapur dhe dinamike* (2011), *Kristoforidhi përmes dokumentimit* (2005), *Stilistika shqipe dhe Pragmatika* (2005), *Rreth alfabetit të shqipes* (2008), *Fjalorët e shqipes me turqishten* (2020), *E duam standardin si gjithë të tjerët* (2022), *Huazimet e shqipes nga turqishtja* (2023) etj.

Profesor Xhevat Lloshi pa dyshim ka qenë dhe është pjesë e aktiviteteve shkencore të Institutit Albanologjik. Për më tepër se tri dekada ka qenë i pranishëm me punime studimore në revistën shkencore “Gjurmime albanologjike” - seria e shkencave filologjike, ku për herë të parë, në vitin 1987, në bashkautorësi me prof. Jani Thomain, boton punimin, *Paralele frazeologjike të shqipes me gjuhë të tjera të Ballkanit*, si dhe në revistën “Gjuha shqipe”, ku për herë të parë në këtë revistë ka botuar më 1998 shkrimin *Shqipja e sotme në kontekste të ndryshme kulturore*. Po ashtu, ka qenë i pranishëm në konferencën e përvitshme shkencore “Java e Albanologjisë”.

Tipologjia e punimeve të profesor Lloshit

Nga tipologjia e shkrimeve të botuara te revista “Gjuha shqipe” shohim se prof. Xh. Lloshi dy çështje i ka trajtuar më së shumti, çështje për të cilat ka njohuri të thella: fushën e shqipes standarde dhe fushën e leksikografisë. Shkrimet si: *Shqipja e sotme në kontekste të ndryshme kulturore*; *Kujdesi për gjuhën - i rrezikuar*; *Zgjidhje që i qëndruan kohës në shërbim të kombit*; *Nga gjuha e normuar prej Kongresit të Drejtshkrimit (1972) te një anarki gjuhësore*; *Citimet dhe drejtshkrimi i shqipes, 50 vjet nga Kongresi i Drejtshkrimit*, janë tregues i preokupimit të profesor

Lloshit, i cili pjesën më të madhe të veprimtarisë shkencore ia ka kushtuar shqipes standarde. Ndërsa, shkrimet *Ndikimi i leksikografisë ruse në hartimin e fjalorëve të shqipes; Dysorët e përftuar nga purizmi; Fjalorët e shqipes me turqishten; Plotësimi i drejtshkrimit dhe leksiku i shqipes*, janë tregues i veprimtarisë së tij të madhe në fushën e leksikologjisë dhe të leksikografisë shqipe. Në këtë revistë, profesor Lloshi ka botuar njëzet shkrime, dy diskutime dhe një recension. Ndërkaq, në revistën “Gjurmime albanologjike”-seria e shkencave filologjike, ka botuar shtatë punime dhe një recension. Tipologjia e temave të trajtuara në punimet e botuara në këtë revistë prek fushën e leksikografisë: *Fjalori i Frang Bardhit dhe fjalësi shqip i Theodor Kavaliotit; Leksiku i shqipes në dy fjalorë të J. G. Von Hahnit (1854) – K. Kristoforidhit (1904);* dy punime nga fusha e shqipes standarde: *Shteti shqiptar dhe zhvillimi i gjuhës letrare shqipe; Komisia Letrare e Shkodrës dhe shqipja standarde si dhe punimet Skënderbeu dhe rimuret islandeze; Ndhimesa të Shaban Demirajt për historinë e shqipes së shkruar.* Në vazhdim do të shtrojmë disa pikëpamje të tij për probleme të ndryshme, në punimet e botuara në revistat e Institutit Albanologjik.

Analizë punimeve shkencore të prof. Xhevat Lloshit

Shkrimin *Për një gjuhë shqipe dinamike*, studiuesi Lloshi e nis me zërat kundërshtues të standardizimit të shqipes, të nxitjeve dhe të fushatave që u bënë në përpjekje për ta ndryshuar atë, në Shqipëri dhe më pas në Kosovë. Ndonëse që nga tryeza e Shkodrës më 1992 dhe me angazhimin e Pipës, fushata u tentua të kthehej në politikë gjuhësore, por ajo nuk ia arriti qëllimit. “Për më së tre vjet u zhvillua një fushatë e shumanshme për ta kthyer këtë në politikë gjuhësore zyrtare dhe u shfrytëzua e gjithë e gjitha koniunktura politike e kohës. Në këto rrethana u shpërfaq se ajo përputhej me përpjekjet për përcarjen kombëtare, për kundërvënien veri-jug deri në konflikt civil”¹. Lloshi, më tutje, thotë se “duhet vënë në dukje se kontestimi i gjuhës standard nuk

¹ Xhevat Lloshi, *Për një gjuhë shqipe dinamike*, në: “Gjuha shqipe”, nr. 1-2/2001, Instituti Albanologjik-Prishtinë, f. 38

arriti të nguliste një politikë për rrëzimin e saj. Megjithatë, gjendja në fushën e politikës gjuhësore të shqipes ka ndryshuar. Jo vetëm nuk ka një politikë të vetme imponuese, jo vetëm janë shfaqur disa drejtime deri në konflikt midis tyre, por edhe tërësia e rrethanave në të cilat hyn shqipja në mijëvjeçarin e ri e shtron si kërkesë përpunimin e një politike që t'u përgjigjet pikërisht rrethanave të reja dhe të mos ngecë në rrjetën e problematikës, që i takon së kaluarës”². Zërat kundërshtues të standardit, me në krye Arshi Pipën, i cili ka folur për ringjalljen e gegërishtes letrare, për dështimin e gjuhës standarde si diçka artificiale, si strategji politike, që i shërbente kolonializmit dhe hegjemonizmit të një pjese minoritet të kombit mbi pjesën tjetër, por në fakt shprehet Lloshi, “ai kërkonte rivendosjen e po kësaj gjendjeje, duke bërë gegërishten e Shkodrës mjet hegjemonizmi të një politike dhe, në rast pamundësie të kolonizimit, të shkëputej pjesa jugore e popullsisë si joshqiptare, si myslimano-bizantine”³. Pipa përmes përçarjes gjuhësore e shihte veten si hero të antikomunizmit, duke e shfrytëzuar si mjet për ta kundërshtuar atë. Lloshi gegërishten e sheh si një shfaqje të pandashme të kulturës kombëtare shqiptare. Çdo përparim i saj është një ndihmesë në pasurimin e shqipes përgjithësisht.

Për kapërcimin e krizës, gjuhëtarët duhet të rifillojnë gjallërisht detyrën e tyre, t'u imponohen me autoritet shkencor institucioneve dhe komunikimit publik, të mos e lënë kulturën e gjuhës në duart e dashamirësve diletantë që shkruajnë në shtyp. Ndërsa, për gjuhën shqipe letrare nevojitet koncepti i gjuhës së hapur dhe i dinamizimit, si baza e një orientimi më të gjerë kulturor kombëtar që të përballojë sfidat e kohës dhe të jetë koncepti mbizotërues i politikës dhe planifikimit gjuhësor për një të ardhme të kapshme. “Na duhet shqipja dinamike në epokën e globalizimit”, shprehet ai.⁴

Profesor Lloshi vazhdon edhe më tutje të trajtojë çështjen e shqipes standarde dhe të Kongresit të Drejtshkrimit. Kështu, në 40-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit, boton shkrimin *Zgjidhje që i*

²Po aty, f. 38.

³ Po aty, f. 39-40.

⁴ Po aty, f. 41.

*qëndruan kohës në shërbim të kombit*⁵, në të cilin me argumente shkencore e me argumente nga praktika 40-vjeçare, shprehet se standardizimi ishte e arritur historike, i cili u dha përgjigjen e qëndrueshme shkencore dhe të çmueshme kombëtare gjithë skenarëve, që do të ishin rrjedhojë e zhvillimeve të panevojshme, se shqipja e ka të ardhmen përpara, sepse dyzet vjet të shkruara u ngrit në lartësinë për të ardhmen. Sipas tij, ishin dy momente vendimtare që çuan te Kongresi i Drejtshkrimit: “Hartimi i Projektit të Ri të Drejtshkrimit më 1967, me prirjen drejt një forme gjuhësore dhe Konsulta Gjuhësore e Prishtinës (prill,1968), e udhëhequr me kryefjalën “Një komb – një gjuhë letrare kombëtare”. Këto ishin dy platforma për kodifikimin e statusit të një varianti gjuhësor, që shërbyen si mbështetje institucionale të politikës së planifikimit gjuhësor. Kongresi i Drejtshkrimit ishte sanksionimi i tyre, pas një diskutimi të gjerë, duke mundësuar marrjen e vendimeve shtetërore përkatëse.”⁶

Kundërshtarëve të Kongresit të Drejtshkrimit Lloshi⁷ u ngarkon barrën, se përgatisin një skenar ogurzi, duke arritur deri aty, sa të botojnë gazeta për të deklasuar standardin, i fajëson se duan dy standarde të ndryshme: për Tiranën dhe për Prishtinën. Lloshi është i bindur se këta dyzet vjet e kanë provuar që tashmë kanë dështuar dhe vetëm dështimi i pret në të ardhmen. Tutje, ai vazhdon me argumentimin e tij se pse shqiptarëve u duhet një shqipe standarde me ç’rast thekson: “në rrethanat në të cilat jetojnë shqiptarët, të ndarë në disa shtete, vetëm standardi i bashkon; në rrethanat e proceseve të avancimit dhe të afrimit të shteteve tona drejt BE-së dhe NATO-s kanë lindur projekte të reja ku kërkohet uniteti gjuhësor, meqenëse nuk e kemi një shtet të vetëm. Andaj, tendenca për t’u kthyer në një kohë pa standard, prapa në histori, do të thotë të goditet vetë shteti shqiptar, t’i vihen atij pengesa në rrugën e përparimit, pa përmendur

⁵ Xhevat Lloshi, *Zgjidhje që i qëndruan kohës në shërbim të kombit*, në: “Gjuha shqipe”, nr. 1/2013, Instituti Albanologjik-Prishtinë, f. 19-26.

⁶ Po aty, f. 25.

⁷ Po aty.

atë që kjo çon deri te përçarja kombëtare e modelit të sllavëve të jugut. Ai model përbën një provë historike, se lakmia për standarde të ndryshme të gjuhës është lajmëtare e sajimit të identiteteve të ndryshme kombëtare drejt shkëputjes së mëpastajme si shtete të veçanta”⁸. Andaj, kombi shqiptar, sot, e ka një gjuhë standarde dhe e ka tejet të nevojshme në rrethanat, kur është i shpërndarë në disa shtete. E ka të domosdoshme një gjuhë zyrtare për shtetin shqiptar. Kombi shqiptar po i plotëson të gjitha kërkesat e veta publike me gjuhën standarde dhe paraqitet në marrëdhënie me shtetet e tjera, duke përdorur një gjuhë standarde. Kështu që, shqipja e standardizuar e ka të ardhmen përpara në një rrugë pasurimi, lëvrimi e përsosjeje.

Ndërkaq, në shkrimin *Nga gjuha e normuar prej Kongresit të Drejtshkrimin (1972) te një anarki gjuhësore*⁹, prof. Lloshi flet për Këshillin Ndërakademik, rolin, synimet dhe argumentet e tij. Në Konferencën e nëntorit 2002, prof. Lloshi u bëri thirrje dy qeverive për krijimin e një Këshilli, i cili do të jepte rekomandime normative për problemet e gjuhës standarde. Më 2004 dy akademitë shqiptare morën vendimin për të ngritur Këshillin Ndërakademik për Gjuhën Shqipe, ndërsa dy vjet më pas, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë Shqipe u shkëput nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, duke e gjymtuar qëllimisht deri në asgjësim ekipin e gjuhëtarëve, që hulumtonin shkencërisht shqipen. Sipas Lloshit, “Këshilli Ndërakademik është pjellë e një sulmi të kamufluar politik kundër shqipes standarde. Është sajësë e shëmtuar politike, e cila pengon rëndë përparimin e kulturës dhe të studimeve gjuhësore. Ky Këshill ka marrë përsipër të fusë pyka në gjuhën standarde dhe, si të nisin të çarat, ta zhbëjë ca nga ca.”¹⁰

⁸ Po aty, f. 23.

⁹ Xhevat Lloshi, *Nga gjuha e normuar prej Kongresit të Drejtshkrimin (1972) te një anarki gjuhësore*, në: “Gjuha shqipe”, nr. 1/2017, Instituti Albanologjik-Prishtinë, f. 53-60.

¹⁰ Po aty, f. 55-56.

Ky Këshill, sipas Lloshit “është plotësisht me prapavijë politike, prandaj ecuria e tij nuk varet nga çështjet gjuhësore, por drejtpërdrejt nga dallgëzimet partiake në Shqipëri. Synimi i tyre ka qenë, që të arrinin të gjenin mbështetjen e plotë shtetërore dhe pastaj sajemat e tyre gjithashtu t’i impononin në rrugë shtetërore, sepse në këtë fushë të vësh në zbatim propozimet, do të thotë t’i bësh me ligj e me forcë administrative”¹¹. Por nuk e kanë gjetur atë mbështetje, që kujtonin se do ta gjenin me lehtësi, sepse pavarësisht prej gjynaheve të politikanëve tanë, këta e kanë pasur nuhatjen se këtu puna mund të shkojë në një tronditje të thellë, si në rastin e piramidave të parave. Në kundërrargumentin e tij që u bën deklaramëve të anëtarëve të Këshillit Ndërrakademik se duhen bërë përmirësime, meqë përvetësimi i standardit qenka i vështirë, profesor Lloshi shprehet se gjuha standarde mësohet, ajo nuk thithet me qumështin e mëmës. Për këtë nevojitet punë. Madje për të mësuar drejtshkrimin e mjaft gjuhëve të tjera evropiane kërkohet një mund shumë më i madh se për shqipen. Në fund, prof. Lloshi shprehet se shteti shqiptar e ka për detyrë të përgatisë një ligj për ringritjen e një institucioni shkencor, që do t’i kushtohet tiparit themelor të kombit, pasurisë së madhe që përfaqëson shqipja jonë.

Në shkrimin *Citimet dhe drejtshkrimi i shqipes*¹², gjuhëtari Lloshi trajton një problem të veçantë lidhur me nevojën për plotësime në fushën e drejtshkrimit, pra, atë të citimeve. Sipas tij, duhet të mbahet parasysh dallimi thelbësor ndërmjet citimeve dhe huazimeve. Huazimet janë fjalë ose togfjalësha nga një gjuhë e huaj, që përdoren në tekste gojore e të shkruara të shqipes, duke iu nënshtuar sistemit të saj. Citimet janë fjalë ose togfjalësha të një gjuhe të huaj, që përdoren në tekste gojore e të shkruara të shqipes, por pa iu nënshtuar fonetikës, drejtshkrimit, gramatikës dhe rregullave të ndërtimit të teksteve të shqipes. Së këndejmi, prof. Lloshi shprehet se “këto janë njësi e huaj në shqipen, nuk janë huazime. Nga pikëpamja

¹¹ Po aty, f. 57.

¹² Xhevat Lloshi, *Citimet dhe drejtshkrimi i shqipes*, në: “Gjuha shqipe”, nr. 2/2022, Instituti Albanologjik-Prishtinë, f. 11-26.

historike, disa fjalë të huaja paraqiten në shqipen në fillim si citime. Më pas, nëpërmjet një procesi të gjatë e jo të thjeshtë, ato mund të shndërrohen në huazime, ndërsa citimet asnjëherë nuk marrin trajta të shqipes, nuk shërbejnë si tema të fjalëformimit, ndonjëherë shoqërohen me përkthime ose shpjegime”¹³. Sipas tij, një fjalë ose një shprehje, që përdoret në një tekst shqip me të njëjtin drejtshkrim si edhe në gjuhën origjinale, do të vështrohet si citim e jo huazim. Tutje në këtë shkrim, studiuesi Lloshi trajton disa problematika që lidhen me natyrën e citimeve.

*50 vjet nga Kongresi i Drejtshkrimit*¹⁴ është shkrim që flet për shënimin e 50-vjetorit të Kongresit , duke trajtuar zërat kundërshtues, qëndrueshmërinë e vendimeve të marra e çështje të mpreha që kërkojnë në kohën tonë etj. Për herë të parë në historinë e shqipes së shkruar është përdorur një variant standard gjatë gjysmë shekulli. Andaj, kjo është shfaqje e qëndrueshmërisë së zgjidhjeve të miratuara dhe mbështet bindjen se kjo qëndrueshmëri ka një të ardhme të sigurt përpara. “Kongresi i Drejtshkrimit ka qenë përgjigje e duhur kundrejt skenarëve të mëhershëm, sikurse atij serb që u përpoqën që të krijonin dy gjuhë, një *albanski jezik* dhe një *shiftarski jezik* dhe është përgjigje edhe ndaj njerëzve me frymëzime antishqiptare të kohës së sotme”¹⁵. Standardi nuk ishte mbrojtës vetëm i bashkimit, i pjesës së brendshme shqiptare, por është mbrojtës edhe i mërgatës. Një shqiptar nëse qëndron në një vend tjetër dhe nuk e ka përvetësuar përdorimin e gjuhës standarde, ai është mjaft i rrezikuar që të humbasë të folmen e vet shqipe. Kurse atij që e ka këtë mjet të përpunuar, ky i shërben për të komunikuar me gjithë shqiptarët me të cilët do të ketë të bëjë atje, pavarësisht nga të folmet e katundeve të tyre dhe, sidomos, i shërben për të ruajtur lidhjet me gjithë kulturën në gjuhën shqipe, sepse standardi është përcjellësi dhe ruajtësi më i pasur i ndërgjegjes kombëtare, shprehet

¹³ Po aty, f. 12.

¹⁴ Xhevat Lloshi, *50 vjet nga Kongresi i Drejtshkrimit*, në: “Gjuha shqipe”, 3/2022, Instituti Albanologjik-Prishtinë, f. 13-19.

¹⁵ Po aty, f. 14.

Lloshi. Andaj, Kongresi i Drejtshkrimit, sipas tij, ishte një veprim vendimtar, me rrezatim të pakufizuar kulturor e kombëtar dhe me vlera praktike të prekshme.

Vështrim mjaft interesant i bën Komisisë Letrare, duke renditur përfitimet që dolën nga kjo Komisi. Pas një analize që i bën disa diskutimeve dhe pas disa sqarimeve që i jep, duke e vlerësuar edhe rolin e konsullit austriak August Kral, shprehet se “e para gjë që vlen të vihet në dukje është se puna e Komisisë Letrare ishte vazhdim i drejtpërdrejtë i Kongresit të Manastirit, jo thjesht sepse u bë vetëm pak vite pas tij, porse ishin ngjarje madhore që kishin të bënin me faktorin qenësor të jetës së një kombi: me ngritjen dhe konsolidimin e shtetit shqiptar.”¹⁶ Merita e parë e Komisisë Letrare, sipas Lloshit, është se ajo nxori në pah, që gjuha standarde është në krye të radhës gjuhë për shtetin, gjuha zyrtare. Ajo tregoi objektivisht që varianti standard ndërtohet mbi bazën e një varianti të shkruar dhe se Komisia vendosi që gjuha e shkrimit të ngulitej mbi një variant të shkruar të gegërishtes. Dhe në fund, Komisia Letrare e shtroi rrugën për të ecur më tej drejt standardizimit të shqipes. Ajo na shfaqet sot si hallka e pamënjanueshme nga Kongresi i Manastirit dhe Kongresi i Elbasanit te Kongresi i Lushnjës, te Konsulta Gjuhësore e Prishtinës e deri te Kongresi i Drejtshkrimit.

Në shkrimin *Kujdesi për gjuhën – i rrezikuar*¹⁷, profesor Lloshi flet për rënien e kujdesit ndaj kulturës së shkrimit të shqipes, duke thënë se gjuha e shkruar nuk është një vazhdimësi e thjeshtë e të folurit. Krejt ndryshe nga gjuha e folur, ajo ka nevojë për mbështetje shkencore, kulturore dhe lëndore, materiale, ajo kërkon siç e quan ai, infrastrukturë. Andaj, kujdesi për zbatimin e normës letrare do të mbetej një dëshirë ndriçimtare po të mos përfshinte seriozisht edhe konceptimin e kësaj infrastrukture, po të mos e ndërtonte me të gjitha hollësitë, po të mos e ndiqte në realizmin konkret, po të mos e gjente

¹⁶ Xhevat Lloshi, *Komisia Letrare e Shkodrës dhe shqipja standard*, në: “Gjuha shqipe”, nr.52/2022, Instituti Albanologjik-Prishtinë, f. 17-24.

¹⁷ Xhevat Lloshi, *Kujdesi për gjuhën - i rrezikuar*, në: “Gjuha shqipe”, nr. 1-2008, Instituti Albanologjik-Prishtinë, f. 34-42.

mbështetjen materiale dhe po të mos e shihte në evoluim, siç është e domosdoshme për çfarëdo infrastrukture tjetër. Ndërsa, duke folur për mbështetjen institucionale që e ka kultura e gjuhës, profesor Lloshi shprehet se “kujdesi për gjuhën ka mbetur pa përkrahjen dhe pa mburojën e shtetit, të cilit në fund të fundit gjuha standarde i bën shërbimin më të madh”¹⁸. Kështu që, si shoqëri, na bie për detyrë jo vetëm në mjetet e komunikimit publik, por edhe në mjediset universitare të përpiqemi ta ngremë prestigjin e standardit, ta ritheksojmë nevojën e tij shtetërore, ekomomike e shoqërore.

Profesor Lloshi ka trajtuar probleme edhe nga fusha e leksikologjisë, një fushë me të cilën është marrë gjatë, është njohës i mirë i saj dhe ka shënuar rezultate të mira. Në një shkrim, i ndarë në dy numra, flet për turqizmat në gjuhën shqipe. *Shpjegime për disa turqizma në shqipen I*¹⁹; *Shpjegime për disa turqizma në gjuhën shqipe II*²⁰. Ndonëse një punë të madhe rreth turqizmave në gjuhën shqipe e ka bërë T. Dizdari kur hartoi Fjalorin e orientalizmeve në gjuhën shqipe, studimi i gjuhës shqipe, sipas Lloshit “ka ecur përpara dhe tashti është e mundur të arrihet një përpikëri shkencore më e madhe, sepse gjatë trajtimeve të ndryshme autorëve u kanë shpëtuar edhe pasaktësi, të cilat nganjëherë kanë sjellë edhe në lexime të gabuara për tekste të autorëve shqiptarë”²¹. Në këtë shkrim, profesor Lloshi ka paraqitur një varg rastesh, kur interpretimi është më i drejtë dhe kështu ka mundësi që të mos përsëritën të njëjtat të meta në punimet e mëtejshme dhe nëpër fjalorë. Ai merr në shqyrtim dhjetëra fjalë, të cilat janë trajtuar si huazime turke, por që në fakt nuk janë, siç qëndron rasti me fjalën *bazukë*, për të cilën thotë se nuk është huazim prej turqishtes, siç e jep Ndreca në fjalorin e tij. Arma është shpikur në Amerikë dhe nuk ka lidhje me Turqinë. Topalli e ka marrë

¹⁸ Po aty, f. 35.

¹⁹ Xhevat Lloshi, *Shpjegime për disa turqizma në shqipen I*, në: “Gjuha shqipe”, nr. 1/2023, Instituti Albanologjik-Prishtinë, f. 21-35.

²⁰ Xhevat Lloshi, *Shpjegime për disa turqizma në shqipen II*, në: “Gjuha shqipe”, 2/2023, Instituti Albanologjik-Prishtinë, f. 69-93.

²¹ Po aty, f. 72.

drejtpërdrejt nga Ndreca pa asnjë qëndrim kritik kundrejt një gabimi kaq të trashë.

Në frymën e huazimeve dhe gjykimit të drejtë e shkencor të tyre, profesor Lloshi paraqitet me një shkrim të gjatë me titull: *Dysorët e përftuar nga purizmi*²². Në këtë shkrim, autori analizon, krahason dhe shpjegon natyrën e huazimeve, dysorëve, neologjizmave, burimin e fjalëve dhe qëndrimin e gjuhëtarëve për gati një shekull rreth kësaj çështjeje. Përkujdesi kryesor i gjuhëtarëve shqiptarë gjatë një shekulli ka qenë që të mos cilësoheshin puristë dhe prandaj e kanë mënjanuar termin *purizëm* me mënyra të ndryshme ose e kanë dënuar. Këtë term nuk e kanë shumë fjalorë, ndonëse *Fjalori i termave të gjuhësisë* më 1975 e ka paraqitur. Edhe kur është përfshirë në fjalorët e gjuhës shqipe (më 2002 dhe 2006), fjala e parë e përkufizimit ka qenë ‘prirje’. Purizmi, sipas Lloshit “nuk është *prirje*, por qëndrim i skajshëm dhe veprimtari për ta mbajtur të pastër gjuhën e vet nga ndikimet, që i quan të huaja. Huazimi është term i përgjithshëm për fjalët e huaja të ardhura nga një gjuhë tjetër në gjuhën shqipe”²³. Pyetja që shtron autori është se në cilën gjuhë shqipe? Sepse nënkuptohet se në gjuhën shqipe kemi një fond fjalësh indoevropiane, si pjesa e trashëguar nga shqipja arkaike ose ilirishtja, si dhe formimet e prejardhura prej tyre. Pastaj kemi fondin e huazimeve nga greqishtja e vjetër, latinishtja dhe sllavishtja. Çabej i ka dalluar këto si huazime të lashta. Ky ka qenë burimi i shqipes së vjetër dhe të dallosh në të huazimet ka domethënie vetëm për studimet etimologjike, por jo për realitetin gjuhësor. Këto janë huazime etimologjike dhe nuk kanë të bëjnë me nocionin e pastërtisë së gjuhës shqipe²⁴. Andaj, huazimi në këtë kontekst, tashmë do të quhej një fjalë jo kundrejt fondit indoevropian, por kundrejt shqipes së vjetër. Pastërtia e gjuhës ka të bëjë me trajtën e shkruar dhe pastaj kjo veprimtari synon që t’i shtrijë arritjet e veta edhe në gjuhën e folur. Pastërtia as nuk lind dhe as

²² Xhevat Lloshi, *Dysorët e përftuar nga purizmi*, në: “Gjuha shqipe”, nr. 1/2011, Instituti Albanologjik-Prishtinë, f. 25-54.

²³ Po aty, f. 25.

²⁴ Po aty, f. 26.

duhet të diskutohet lidhur me gjuhën e folur. Sipas tij, deri në fund të shek. XVIII do të flasim për huazime të vjetra, për huazime etimologjike dhe, rrjedhimisht, këto nuk do të përfshihen në vështrimet për pastërtinë e gjuhë. Nga kjo pikëpamje, shprehet autori, nuk do të ishte e pranueshme, që puna për pastërtinë e gjuhës të nisej nga Budi. Budi është shprehur se gjuha shqipe po *bdarej* jo në kuptimin që po prishej nga pikëpamja e pastërtisë, porse po humbiste ngaqë nuk po lëvrohej prej letrarëve dhe nuk po mësohej në shkolla. Dëshmia më e mirë për këtë është se në librat e tij ka mjaft huazime dhe fjalë thjesht të huaja.

Fundi i shekulli XVII dhe fillimi i shekullit XVIII shënon hyrjen në shqipen e re. Në këtë etapë sipas Lloshit “do të flasim për huazime të reja kundrejt fondit të ardhur prej fazave të mëparshme dhe këto përbëjnë fushën e pastërtisë së gjuhës shqipe. Për pastërtinë dhe purizmin mund të flitet afërsisht gjatë tre shekujve të fundit, por jo më përpara, jo për shqipen arkaike, të vjetër dhe mesjetare.”²⁵

Zakonisht si sinonim për huazimet përdorim togfjalëshin ‘fjalë të huaja’. Po të synojnë një përpikëri të rreptë shkencore, ky njëjtësim sipas Lloshit nuk qëndron, “fjalë të huaja janë ato njësi, të cilat nuk i përkasin gjuhës shqipe, por për arsye të ndryshme përdoren në tekste shqipe, ndërsa mbeten njësoj të huaja për shqipen. Të tilla janë *in vitro*, *ad literam*, *idem*, *de jure*. Ndodh që ndonjë fjalë e huaj të shndërrohet në huazim. Kështu *har-ware* dhe *soft-ware* janë terma të nevojshëm, por janë fjalë të huaja dhe nuk mund të parashikojmë se si do të kthehen në huazime apo si do të zëvendësohen. Prandaj, sipas tij, duhet të dallohen fjalët e huaja *jo huazime* dhe fjalët e huaja si sinonim me *huazimet*. Ndarje tjetër që duhet të bëhet është në *huazime të nevojshme* dhe *huazime të panevojshme*”²⁶. Përgjithësisht pranohet se ndërkombëtarizmat janë huazime të nevojshme. Një dukuri tjetër që lidhet me këtë fushë është ndërtimi i fjalëve të reja ose neologjizmave. Në këtë mes, përmend punën e Veqilharxhit, për të cilin thotë se ka një varg neologjizmesh të dështuar. Lloshi

²⁵ Po aty, f. 27.

²⁶ Po aty.

paraqitet mjaft kritik se pse nuk thuhet qartë se përpjekjet e tij ishin të pafrytshme e të gabuara. Nuk kemi çfarë të mësojmë nga sajimet e tij që nuk kanë lënë asnjë gjurmë në lëvrimin e shqipes së shkruar. Veqilharxhi nuk e ka pastruar shqipen. Ai ndodhej përpara vështirësive të kuptueshme, si për çdo autor të cilit i është dashur të shkruajë shqip në një fushë ku mungonte terminologjia. Ai është munduar të shkruajë një shqipe të pastër, por nuk ka qenë në gjendje të orientohet nga terminologjia ndërkombëtare e fushës, mendonte vetëm me termat e greqishtes dhe kishte ngecur në modelet e saj. Kjo e metë, sipas tij, “shfaqet edhe te rilindësit e tjerë, si Vretoja e Laurasi e të tjerë autorë, të cilët përpiqeshin të shkruanin pastër shqip, por në të vërtetë kishin ngecur keq në kthetrat e greqishtes.”²⁷

Pastrimi i shqipes nënkupton edhe një nocion tjetër: zëvendësimin e huazimeve. Ky është qëllimi i vërtetë, synimi përfundimtar i kësaj veprimtarie. Sipas tij, këtu duhet të përqendrohen gjurmimet tona me sy shkencor. Andaj, nga vëzhgimet e bëra te realiteti gjuhësor nga ky këndvështrim, Lloshi arrin në përfundim se “veprimtaria për pastrimin e gjuhës shqipe ka arritje të pjesshme. Ka dështuar purizmi, madje ai është pengesë për pastrimin e shqipes. Përfundimi i pjesës më të madhe të propozimeve për zëvendësimin e huazimeve ka qenë përfthimi i dysorëve. Pastrimi i gjuhës shqipe gjatë një shekulli e gjysmë ka sjellë një gjendje të re në gjuhën shqipe, duke e shtuar sinonimin me dysorë. Vetëm pas studimit të kësaj gjendjeje mund të diskutohet mbi baza shkencore se çfarë drejtimi do të kishin përpjekjet tona të mëtejshme”²⁸. Shtimi i dysorëve, thekson Lloshi, nuk nënkupton se është dukuri negative. Përkundrazi, shtimi i tyre e kanë pasuruar shqipen me një rrjetë sinonimesh të vlefshme, që na mundësojnë të shkruajmë më mirë. Shqipja është bërë më e zhdërvjellët, por nuk ka arritur t’i zëvendësojë fjalët e huaja. Kështu, në përpjekje për ta zëvendësuar fjalën e huaj është shtuar sinonimia, por nuk ka arritur të heq atë fjalë, p.sh.: për fjalën *afeksion* është parashtruar të zëvendësohet me

²⁷ Po aty, f. 28.

²⁸ Po aty, f. 29.

njërën nga fjalët *dashuri, ndjenjë, zemërngrohtësi, ngrohtësi, përzemërsi; përvetoj, përvetësoj, përngjashmoj; për asimiloj; pamje, anë pikëpamje, vështrim për aspekt; zë, pajtoj, hedh përfshijë për angazhoj*. Sipas Lloshit, këto janë sinonime shumë të këndshme e të dobishme, por nuk ia merr mendja se dikush do të mësojë pesë fjalë shqip për të zëvendësuar një fjalë të huaj.

Fundin e këtij shkrimi të gjatë e mirë të argumentuar, Lloshi e përmbyll me thirrjen: “sot, kur shqipja ndodhet në rrethanat e trysnisë së globalizmit, për të çelur një drejtim që t’u përgjigjet kërkesave të kohës në fushën e pasurimit e të pastrimit nevojitet koncepti i ri i gjuhës së hapur e dinamike. Sipas këtij koncepti, qëndrimi ndaj huazimeve do të përmbliidhej në këtë kërkesë për ata që shkruajnë shqip: përdorni cilën fjalë që të doni, por ta dini se çfarë përdorni. Shqipja ka një visar jo të varfër, pavarësisht se gjuhëtarët nuk e bëjnë mirë detyrën e tyre për ta njohur ata, të cilëve u duhet, nuk janë të aftë të ndjekin procesin gjuhësor në shtjellimin e tij të hapur, për typin ide të vjetruara, përsërisin po ato gjëra dhe përfundimisht u mungon guximi të përballen në vazhdimësi me prirjet e modës, me opinionin publik”.²⁹ Detyra e gjuhëtarëve kërkon qëndrimi aktiv: të ndjekin pa ndërprerje zhvillimet e gjuhës së shkruara, të shpjegojnë pa u lodhur natyrën e fjalëve, të tregojnë burimet e gabimeve dhe të nxjerrin në dukje pasurinë e shqipes. Dhe vetëm kur të jetën të bindur shkencërisht se ia kanë arritur t’i plotësojnë kërkesat për fjalët e reja, atëherë le të paraqesin edhe ndonjë propozim ose neologjizëm. Paraqitja e propozimeve, qoftë edhe me fjalët, është fundi i punës dhe jo fillimi siç është bërë deri më tash për shkak të purizmit, shprehet ai.

Përfundime

Nga ajo që shtjelluam më lart shohim thellësinë e argumentimit në temat e trajtuara, duke i parë problemet e fushave të ndryshme

²⁹ Po aty, f. 47.

nga një kënd më i gjerë. Në temat e trajtuara, si ajo e shqipes standarde e diskutimeve për të si dhe nga fusha e huazimeve, autori imtësisht e shkencërisht sjell mbështetje logjike e shkencore dhe pohon se vendimet e Kongresit ishin të qëndrueshme. Duke e përfunduar këtë punim, mund të themi se profesor Lloshi është figurë poliendrike e gjuhësisë shqiptare, njohës i mirë i disa fushave shkencore sidomos i fushës së leksikografisë, leksikologjisë, shqipes standarde e kulturës së gjuhës. Ndhimesat e tij kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë thelbësore në studimet e shqipes, ku edhe sot e kësaj dite është aktiv. Nga ajo që e kemi vërejtur në punimet e tij, mund të themi se prof. Lloshi është një ndër të paktë gjuhëtarë shqiptarë që kritikën shkencore e ka të zhvilluar, duke qenë i drejtpërdrejtë dhe tejet argumentues në mendimet dhe në qëndrimet e tij shkencore. Ndhimesa gjuhësore e tij në revistat shkencore të Institutit Albanologjik ka qenë dhe vazhdon të jetë thelbësore për gjuhën shqipe dhe për albanologjinë përgjithësisht.

Bibliografia e punimeve të prof. Xhevat Lloshit në revistën “Gjuha shqipe”

1. Lloshi, Xhevat , *Shqipja e sotme në konstekste të ndryshme kulturore*, në:”Gjuha shqipe”, nr. 1/1998, Instituti Albanologjik.
2. Lloshi, Lloshi, *Për një gjuhë shqipe dinamike*, në: “Gjuha shqipe”, nr. 1-2-2001, Instituti Albanologjik.
3. Lloshi, Xhevat, *Mësimi i shqipes në rrethanat e reja.*, në:”Gjuha shqipe”, nr. 1-2/2003, Instituti Albanologjik.
4. Lloshi, Xhevat, *Përmirësimi i librave për nxënësit*, në:”Gjuha shqipe”, nr. 2/2006, Instituti Albanologjik.
5. Lloshi, Xhevat, *Kujdesi për gjuhën - i rrezikuar*, në:”Gjuha shqipe”, nr. 1/2008, Instituti Albanologjik.
6. Lloshi, Xhevat, *Ndikimi i leksikografisë ruse në hartimin e fjalorëve të shqipes*, në:”Gjuha shqipe”, nr. 2/2008, Instituti Albanologjik.

7. Lloshi, Xhevat *Dysorët e përftuar nga purizmi*, në: “Gjuha shqipe”, nr. 1/2011, Instituti Albanologjik.
8. Lloshi, Xhevat, *Zgjidhje që i qëndruan kohës në shërbim të kombit*, në: “Gjuha shqipe”, nr. 1/2013, Instituti Albanologjik.
9. Lloshi, Xhevat – Lafe, Emil , *Shteti shqiptar dhe zhvillimi i gjuhës letrare*, në: “Gjuha shqipe”, nr. 2/2013, Instituti Albanologjik.
10. Lloshi, Xhevat, *Pjesëmarrja e Rajko Nahtigalit në Komisinë Letrare të Shkodrës*, në: “Gjuha shqipe”, nr. 3/2016, Instituti Albanologjik.
11. Lloshi, Xhevat, *Nga gjuha e normuar prej Kongresit të Drejtshkimit (1972) te një anarki gjuhësore*, në: “Gjuha shqipe”, nr. 1/2017, Instituti Albanologjik.
12. Lloshi, Xhevat, *Sa e vjetër është fjala “sot”?*, në: “Gjuha shqipe”, nr. 2/2017, Instituti Albanologjik.
13. Lloshi, Xhevat, *Fjalorët e shqipes me turqishten*, në: “Gjuha shqipe”, nr. 1/2018, Instituti Albanologjik.
14. Lloshi, Xhevat, *Gjuhëtari amerikan Eric P. Hamp për shqipen*, në: “Gjuha shqipe”, nr. 1/2019, Instituti Albanologjik.
15. Lloshi, Xhevat, *Citimet dhe drejtshkrimi i shqipes*, në: “Gjuha shqipe”, nr. 2/2022, Instituti Albanologjik.
16. Lloshi, Xhevat, *50 vjet nga Kongresi i Drejtshkimit*, në: “Gjuha shqipe”, nr. 3/2022, Instituti Albanologjik.
17. Lloshi, Xhevat, *Shpjegime për disa turqizma në shqipen I*, në: “Gjuha shqipe”, nr. 1/2023, Instituti Albanologjik.
18. Lloshi, Xhevat, *Emil Lafja përfaqësuesi më i shquar i kulturës dhe i gjuhësisë shqiptare*, në: “Gjuha shqipe”, nr. 2/2023, Instituti Albanologjik.
19. Lloshi, Xhevat, *Shpjegime për disa turqizma në gjuhën shqipe II*, në: “Gjuha shqipe”, nr. 2/2023, Instituti Albanologjik.
20. Lloshi, Xhevat, *Mungesa e simetrisë*, në: “Gjuha shqipe”, nr. 3/2023, Instituti Albanologjik.

Diskutime

21. Lloshi, Xhevat, *Plotësimi i drejtshkrimin dhe leksiku i shqipes*, në: "Gjuha shqipe", nr. 2/2013, Instituti Albanologjik.
22. Lloshi, Xhevat, *Pak a shumë*, në: "Gjuha shqipe", nr. 1/2024, Instituti Albanologjik.

Kritika dhe recensione

1. Lloshi, Xhevat, *Gjuha e Fishtës në një studim tërësor*, (Shefkije Islamaj, *Gjergj Fishta, Gjuha dhe stili I, II*, Instituti Albanologjik-Prishtinë, 2012, 1100 f.), 2013, në: "Gjuha shqipe", nr. 1/2013, Instituti Albanologjik.

Bibliografia e punimeve të prof. Xhevat Lloshit në revistën "Gjurmime albanologjike" – seria e shkencave filologjike

1. Lloshi, Xhevat- Thomai, Jani, *Paralele frazeologjike të shqipes me gjuhë të tjera të Ballkanit*. (Paralleles phraseologiques de l'albanais avec d'autres langues), në: "Gjurmime albanologjike" – seria e shkencave filologjike, nr. 17/1987, Instituti Albanologjik.
2. Lloshi, Xhevat, *Skënderbeu dhe rimuret islandeze*, (Scanderbeg in Icelandic Rimurs), në: "Gjurmime albanologjike" – seria e shkencave filologjike, nr. 2006, nr. 34/35-2004/2005, Instituti Albanologjik.
3. Lloshi, Xhevat, *Fjalori i Frang Bardhit dhe fjalësi shqip i Theodor Kavaliotit*. (The dictionary of Frang Bardhi and vocabulary of Theodor Kavaliot), në: "Gjurmime albanologjike" – seria e shkencave filologjike, nr. 36/2006, Instituti Albanologjik.
4. Lloshi, Xhevat- Lafe, Emil, *Shteti shqiptar dhe zhvillimi i gjuhës letrare shqipe*, në: "Gjurmime albanologjike" – seria e shkencave filologjike, nr. nr. 41/42-2011/2012.

5. Lloshi, Xhevat, *Ndihmesa të Shaban Demirajt për historinë e shqipes së shkruar*, në: "Gjurmime albanologjike" – seria e shkencave filologjike, nr. 50/2020, Instituti Albanologjik.
6. Lloshi, Xhevat *Leksiku i shqipes në dy fjalorë J. G. Von Hahn (1854) – K. Kristoforidhi (1904)*, në: "Gjurmime albanologjike" – seria e shkencave filologjike, nr. 51/2021, Instituti Albanologjik.
7. Lloshi, Xhevat, *Komisia Letrare e Shkodrës dhe shqipja standarde*, në: "Gjurmime albanologjike" – seria e shkencave filologjike, nr. 52/2022, Instituti Albanologjik.

Recension

1. Lloshi, Xhevat, *Hysen Sinani: Fjalor i greqishtes së re – greqisht-shqip*. Bashkëkohor, frazeologji, me sinonime dhe antonime, Sh.B. "West Print", Tiranë, 2012, f. 730, në: "Gjurmime albanologjike" – seria e shkencave filologjike, nr. nr. 41/42-2011/2012, Instituti Albanologjik.

LINGUISTIC CONTRIBUTION OF PROFESSOR XHEVAT LLOSHI IN THE JOURNALS OF THE INSTITUTE OF ALBANOLOGY

Summary

Professor Xhevat Lloshi stands out as one of the most prominent figures in the Albanian linguistics. His contributions are both extensive and rich, making him one of the most prolific linguists. His body of work includes a variety of original studies encompassing, monographs, studies, articles, conference papers, written pieces, reports and interviews, thereby establishing his presence across Albanian-speaking area. As to the Albanian language studies, he is particularly esteemed for his contributions to lexicography and lexicology, stylistics, and the historical analysis of written Albanian by notable authors such as Kristoforidhi, Frashëri, and Qiriazi. Furthermore, he has made valuable contribution to the standardization of the language and the promotion of language culture. He also participated in the Albanian Orthography Congress.

Professor Xhevat Lloshi has unquestionably been part of the scientific endeavors at the Institute of Albanology for several decades. For over thirty years, he has contributed to the field through his research papers published in the scientific journal “Gjurmime albanologjike [*Albanological Research*]” - in the series dedicated to philological sciences. Notably, in 1987, he co-authored with Professor Jani Thomai a paper titled *Paralele frazeologjike të shqipes me gjuhë të tjera të Ballkanit* [*Phraseological parallels of the Albanian language with other languages of the Balkans*]. Additionally, he made his first contribution to the journal “Gjuha shqipe [*Albanian language*]” in 1998 with the article titled *Shqipja e sotme në kontekste të ndryshme kulturore* [*Today's Albanian in different cultural contexts*]. Furthermore, he has also participated in the annual scientific conference known as “Albanology Week.”

Professor Lloshi has contributed to the field of Albanological studies by publishing 20 written pieces, 2 discussions, and 1 review in the journal "Albanian Language." Additionally, in the journal "Albanological Research," – in the series of philological sciences, he published 7 conference papers and 1 review, providing valuable insights in the field of Albanology into topics requiring scientific discussions.